STATUTI I SHOQERISE AKSIONARE " **S-K & B-K OIL**" SH.A

**SADIK PISHA** - i datelindjes 14.05.1977 lindur ne Elbasan mbajtes i leternjoftimit, me numer personal H70514004Q.

Dhe

**BILBIL KASTRATI** - i datelindjes 04.08.1976 lindur ne Brrut Kukes dhe banues ne Rruga Taulantia Durres, mbajtes i leternjoftimit, me numer personal H60804113C.

Ne cilesine e aksionareve themelues te shoqerise "**S-K & B-K OIL**" Sh.a. kane vendosur te miratojne dhe nenshkruajne statutin e kesaj shoqerie ne
perputhje me kushtet si me poshte:

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria Tregtare "**S-K & B-K OIL** " Sh.a. rregullon poziten e saj juridike, te organeve te saj, Llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarisc se saj, marredheniet me te punesuarit. duke u bazuar ne ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe dispozit.it e tjera te Iegjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojnc marredheniet e Shoqerive.

### Neni 1
### Emri dhe selia e Shoqerise

1- Emertimi i plote i shoqerise aksionarc me oferte private eshte "**S-K & B-K OIL**" Sh.a.
2- Shoqeria gjithashtu mund te ndryshoje seline e saj, si dhe te vendose dht te hape apo te mbylle filiale, agjensi. dege. magazina, zyra dhe perfaqesi ne cdo rast qe e konsideron te dobishme ose fitimpinre.se per aktivitetin e shoqerise, me vendim te organeve drejtuese.
3- Selia e Shoqerise eshte ne Adresen: ish Uzina 12 , Kombinati Metalurgjik, Bradashesh Elbasan, zona kadastrale 3962 , pasuria me nr. 195/3.

### Neni 2
### Kohezgjatja e Shoqerise

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit eshte i pakufizuar.Aksioneret e Shoqerise mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarisc dhe me pas zgjatjen e saj njc apo disa here, me vendim te Asamblese se Aksionare.

### Neni 3
### Regjimi Juridik i Shoqerise

- Shoqeria **S-K & B-K OIL**" Sh.a eshte nje shoqeri aksionare (Sh.a.). Veprintaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi apo cdo ligji ne fiiqi ne Republiken e Shqipcrise.
- Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Statutit te saj.
- Shoqeria ka vulen e saj.

**Neni 4**
**Objekti i Veprimtarise**

Importi-eksporti, shitja me shumice i karburanteve dhe produkteve derivate te tyre si nafta, benzina, karburanti i perdorur ne aviacion, vajra, lubrifikant, solari, etj perfshire dhe biokarburantet dhe nenproduktet e ketyre te fundit.
Shoqëria mund te zhvilloje gjithashtu çdo aktivitet tjetër plotësues e ndihmës që rezulton i dobishme dhe/ose i nevojshëm për përmbushjen e objektit kryesor, duke përfshirë tregtimin e produkteve dhe kryerjen e shërbimeve të tjera.
Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti: Importi Importi – eksporti, depozitimi, tregtimi, transformimi, transporti i gazit te lengshem te naftes (GLN), gazit propan, gazit metan, pjeseve perberese ose perzieresve te tyre si dhe te gjitha llojeve te tjera te gazrave teknike per perdorim industrial dhe civil. Importi – eksporti, shitja e bombolave te gazit te te gjitha dimensioneve dhe per te gjitha perdorimet.
Tregtimi dhe rimbushja e bombolave te gazit.

**Neni 5**
**Kapitali Aksioner-Aksionet**

Kapitali aksionar i shoqerise eshte **3.500.000 leke.**
Kapitali aksionar i shoqerise eshte ndare ne 2 aksione te zakonshme me nje vlere nominale **1.750.000 leke secili.**

Aksionaret themelues zoterojne nga **50%** te aksioneve secili dhe perkatesisht:

**z. SADIK PISHA** - zoteron 1 aksion me vlere prej **50 % te aksioneve** secili te barabarte me nje pjesmarrje ne kapital prej 1.750.000 lekesh.

**z. BILBIL KASTRATI** - zoteron 1 aksion me vlere prej **50 % te aksioneve** secili te barabarte me nje pjesmarrje ne kapital Prej 1.750.000 lekesh.

Cdo aksion i zakonshem i jep zoteruesit te tij te drejta vote ne raport proporcional me pjesen e kapitalit qe perfaqeson aksioni.
Ndalohet emetimi i akioneve te cilat i japin zoteruesit te tyre me shume te drejta vote, ne raport me pjesen e kapitalit qe aksioni perfaqeson.

Aksionaret kane shlyer ¼ e vleres se kapitalit te nenshkruar ne menyre proporcionale me pjesmarrjen ne shoqeri ne llogarine e shoqerise sic parashikohet ne ligj dhe do vijojne te shlyjne vlerat perkatese sipas dispozitavc ligjore dhe ketij Statuti.

Shoqeria mund te rrise kapitalin me ane te nje rezolute te Mbledhjes se Pergjithshme pas:

(i) perfshirjes se rezervave ne dispozicion dhe te ardhurave neto te paperdorur\ nga veprimtarite e mikro- kreditit;
(ii) kontrihute shtese te Themeluesvc ekzistues:
(iii) apo pranim me pranimin e pjesemarresvc tc rinj ne shoqeri

## Neni 6
## Organet e Shoqerise

Organet e shoqerise jane:

1- Asambleja e Pergjithshme
2- Keshilli Mbikqyres
3- Administratoret

- Eksperti Kontabel – **Andon Kristo** – Person Fizik i regjistruar ne QKB me nr. NIPT K32803233V.

## Neni 7
## Asambleja e pergjithshme

Asambleja e pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhime te shoqerise:

a. percaktimin e politikave tregtare;
b. ndryshime tc statutit;
c. emerimin e shkarkiniin e anctareve te keshillit mbikqyres dhe te administratorcve te shoqerise;
d. emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te ekspertevc kontabel te autorizuar:
e. miratimin e skemes se shperblimeve per personal e permendur ne shkronjat "c" e te kesaj pike:
f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tc raporteve te ecurise so veprimtarise:
g. shpemdarjen e fitimeve vjetore;
h. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
i. pjesetimin e aksioneve dhe anulimin e tyre
j. ndryshime ne te drejtat qe lidhen me aksione te llojeve e kategorivc te vccanta;
k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit:
l. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
m. miratimin c rregullave procedural te mbledhjeve te saj

Asambleja e pergjithshme merr vendime pas shqyrtimit te dokumenteve perkatese se bashku me raportin e keshillit mbikqyres dhe raportin e ekspertit kontabel te autorizuar

## Neni 8
## Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- Asambleja e pergjithshme mblidhet dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per tc mbrojtur interesat e shoqerise

- Asambleja e pergjithshme thirret nga adminislratoret dhe ne rastet e parashikuara nga ligji, nga anetaret e kcshillit mbikqyres dhe nga administratoret

- Asambleja e pergjithshme duhet te thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton apo parashikohet qarte se humbjet arrijne te nje vlere te barabarte me 50 per qind te kapitalit te regjistruar ose qe aktivet e shoqerise nuk mbulojne detyrimet, qe jane te kerkueshme brenda 3 muajve ne vijim.

- Asambleja e pergjithshme duhet te thirret. kur shoqeria propozon te shese apo tc disponoje active te cilat kane

nje vlere me te larte se 5 per qind te asetcve tc shoqcrise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara:

- Asambleja e pergjithshme duhet te thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit, propozon te bleje nga nje aksionar, pasuri qe kane vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuar.

- Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri 5 te ketij Nenim asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar i pavarur.

**Neni 9**
**Menyra e Thirrjes**

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nepermjet postes elektronike.
2. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik dhe rendi i dites u dergohen te gjithe aksionareve, 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
3. Ky njoftim duhet te permbaje. Gjithashtu:
- emrin e shoqerise, seline e regjistruar, vendin dhe oren e mbledhies se asamblese
- nje sqarim te hollesishcm te procedurave, qe duhet te ndiqen nga aksionaret per te marre pjese dhe votuar ne asamble, e cila duhet te perfshije;
- te drejtat e aksionareve
- procedural e votimit me prokure, formulare te posacem, per t'u perdorur gjate votimit me prokure dhe mjeict elektronike me te cilat shoqeria do te pranoje njofimin e perfaqesuesve te autorizuar.
- procedurat per votimin me mjete elektronike apo me korrespondence
- informacion per vendin e menyrat per te marre ne forme te plote dokumentet dhe projektvendimet e pcrcaktuara
- adresen e faqes se internetit te shoqerise ku mund te merret informacioni i percaktuar ne kete nen
- Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme se bashku me rendin e dites vendosen edhe ne faqcn e internetit te shoqerise.

**Neni 10**
**Rendi i dites**

1- Rendi i dites, qe njoftohet sipas Nenit me siper, duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per cdo ceshtje.
2- Nese asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ndryshimin e statutit. teksti i ndryshimeve duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.
3- Administrators duhet t'i pergjigjen, me shkrim. cdo kerkcse me shkrim per sqarim per rendin e dites derguar nga aksionaret jo me vone se 8 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
4- Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas formaliteteve te kerkuara ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe aksionaret jane te pranishem dhe shprehen dakord per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

## Neni 11

## Pjesemarria ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme

- Asambleja e pergjithshme cakton njc kryetar te asamblese si dhe nje sckretar te saj.
- Gjate mbledhjes se asamblese se pergjithshme pergatitet lista aksionareve te pranishem ose te perfaqesuesve te tyre, ku shenohen emrat dhe adresat e secilit se bashku me numrin e aksioneve, numrin e votive qe keto aksione japin vleren nominale te aksioncve, si dhe llojin apo kategorine e tyre, te zoteruara nga secili pjesemarres.
- Kjo liste u vihet ne dispozicion aksionareve osc perfaqesuesve te tyre dhe nenshkruhet prej tyre.
- Aksionaret nepermjet nje marreveshjeje unanime me shkrim mund te vendosin qe çdo vendim qe ata kane te drejte te marrin sipas ligjit apo statutit te shoqerise, te merret ne menyre unanime.

## Neni 12

## Procesverbalet e mbledhjeve te asamblese

- Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e procesverbaleve.
- Procesverbali duhet te permbaje te dhenat vijuese: daten e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e dites. emrin e kryetarit dhe te mbajtesit te procesverbalit, rezultaiet e votimit, vendimet e marra, qendrimin e kryetarit per vendimmarrjen si dhe te aksionareve, qe jane shprehur kunder.
- Procesverbalit i bashkelidhen edhc lista e pjescmarresve dhe dokumentacioni i thirrjes se asamblese se pergjithshme
- Procesverbali dhe lista e pjescmarresve duhet te nenshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- Jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes, administratoret jane te detyruar te publikojne kopje te procesverbalit te mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne faqen e internetit te shoqerise.

## Neni 13

## Kuorumi

Ne rastin e ceshtjeve, qe vendosen me shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese jane te pranishem ose te paperfaqcsuar aksionaret. qe zoterojne me shume se 30 per qind te aksioncve me te drejte vote.

## Neni 14

## Marrja e vendimeve

1- Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te aksionareve qe marrin pjese ne votim ne lidhje me ndryshimin e statutit zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shpemdarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
2- Asambleja e pergjithshme merr vendime per ceshtjet e tjera me shumicen e votave te aksionareve, qe marrin pjese
3- Vlefshmeria e vendimeve, qc percaktojne detyrime shtese mbi aksionaret apo vendimet, qe kufizojne te drejtat e tyre, kushtezohet nga miratimi i aksionarit perkates.

**Neni 15**

**Menyra e votimit**

1- Asambleja e pergjithshme merr vendimet, nepermjet votimit te hapur
2- Per emerimin dhe shkarkimin e anetareve te keshillit mbikqyres apo administratoreve, asambleja e pergjithshme vendos me votim te fshehte, nese kjo menyre votimi kerkohet nga aksionaret te cilet zoterojne nje numer aksionesh, qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te kapitalit te regjistruar te shoqerise,

**Neni 16**

**Shfuqizimi i vendimeve te parregullta dhe demshperblimi**

1- Asambleja e pergjithshme ka te drejte t'i kerkoje gjykates kompetente shfuqizimin e vendimeve te administratoreve e, sipas rastit te keshillit mbikqyres kur keto vleresohen si shkelje te renda te ligjit ose te statutit.

2- Aksionaret, qe perfaqesojne te pakten 5 perqind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise dhe/ose krediloret e shoqerise te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5 perqind te kapitalit te regjistruar mund t'i kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise si me siper. Aksionaret apo kreditoret e shoqerise, te percaktuar me siper brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrene padi drejtperdrejt perpara gjykates perkatese per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e aksionareve apo e kreditoreve vleresohet e refuzuar.

**Neni 17**

**Te drejtat e lidhura me aksionin**

Aksionari qe pengohet te ushtroje te drejtat te cilat rrjedhin nga zoterimi i aksionit te shoqerise ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo te kerkoje demshperblim. Padia duhet ngritur brenda 3 vjeteve pas pengimit te ushtrimit te se drejtes.

## III. KESHILLI MBIKQYRES DHK ADMIMSTRATORET

**Neni 18**

**Keshilli Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres eshte organi qe kqyr venien ne zbatim te politikave tregtare dhe strategjike te shoqerise si dhe keqyr dhe perputhjen e tyre me ligjin dhc siatutin

Keshilli Mbikqyres ka keto te drejta dhe pergjegjesi

a. te jape direktiva per administratoret per zbatimin e politikave tregtare te shoqerise:
b. te kontrolloje e te mbikeqyre zbatimin e politikave tregtare te shoqerise nga administratoret;
c. te pergatise, me kerkese te asamblese se pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, t'i rekomandoje asaj vendime te nevojshnie per t'u marre, si dhe te zbatoje vendimet e asamblese;

d. te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme, sa here vleresohet e nevojshme per interesat e shoqerise;
e. te kujdeset qe shoqeria tc respektoje ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
f. te shqyrtoje e te kontrolloje librat kontabel, dokumentet dhe aktivet e shoqerise;
g. te siguroje se pasqyrat financiare vjetore, raportet c ecurisc se veprimtarisc, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme nc baze te ligjit apo statutit, te kryhen me saktesi nga administratoret. Keto dokumente duhet te miratohen e te ne shkruhen nga te gjithe e anetaret e Keshillit Mbikqyres per t'iu paraqitur asamblese se pergjithshme. e bashku me nje raport te Keshilli Mbikqyres per miratim dhe nje pershkrim per mbikeqyrjen e menaxhimit gjate te gjithe vitit financiar.
h. te siguroje se auditimi i librave dhe i regjistrimcve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblese se pergjithshme, t'u vihet ne dispozicion te gjithe anetareve te keshillit e administratoreve Raporti i Keshilli Mbikqyres permendur ne shkronjen "e" te kesaj pike, duhet te pennbaje edhe mendimin per raportin e auditimit;
i. te percaktoje shperblimin e administratoreve;
j. te miratoje manjen persiper te dctyrimcve me vlere me tc larte se 5 per qind te aseteve tc shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiarc te certifikuara nepermjet nenshkrimit te huavc apo emetimit tc obligacioncvc apt) instrumentevc te tjera te borxhit;
k. te vendose krijimin e bashkepunimevc tregtare afatgjata dhe pro lozimin e politikave. per theinelimin e shoqerivc tregUire ose te grupeve te reja.

## Neni 19
## Numri, emertimi dhe perberja e keshillit te mbikqyres

Keshilli mbikqyres do te perbehet nga 3 anetare.
Anetaret jane individe, dhc te ndryshem nga administratoret e shoqerise. Anetaret e keshillit mbikqyres zgjidhen nga asambleja e pergjithshme me shumicen e votave te aksionereve qe marrin pjese dhe per nje afat trevjecar.
Anetaret e keshillit mbikqyres mund te rizgjidhen.
Anetaret e pare te Keshilli Mbikqyres do te jene:
1-SADIK PISHA
2-BILBIL KASTRATI
3-ANDREA KRISTO

## Neni 20
## Shkarkimi

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje, ne cdo kohe. nje anetar te keshillit mbikqyres, me shumice te thjeshtc votash.
Kjo e drejte nuk mund te percaktohet nga statuti apo me marreveshje. Padite, qe lidhen me shperblimin e anetarit, ne baze te marredhenievc kontraktore me shoqerine rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
Anetari i keshillit mbikqyres mund te shkarkohet me vendim te aksionareve te pakices. qe e ka zgjedhur.
Kur kushtet e parashikuara ne statut per kete emerim te ve^A ntc nuk jane me ne fuqi, asambleja e pergjithshme mund ta shkarkoje anetarin ne fjale me shumice tc thjeshte votash. Keshilli mbikqyres me shumice te thjeshte votash mund t'i kerkoje gjykates perkatese te shkarkoje nje anetar, nese ai ka shkelur detyrat e parashikuara per tc nga ligj.

## Neni 21
## Mbledhjet

1- Keshilli Mbikqyres merr vendime me me shumice te thjeshte te te drejtave te anetareve te pranishem.Vendimet e Keshilli Mbikqyres jane te vlefshem nese ne procesm e vendimarrjes jane te pranishem ose te pcrfaqesuar 50 perqind plus nje te anetarcve tc ij.
2- Anetaret e Keshillit Mbikqyres qe mungojne, mund te perfaqesohen nga cdo person i autorizuar prej tyre.
3- Marrja e vendimeve kryhet nepcrmjet votimit me shkrim

## Neni 22
## Administratoret

1- Administratori/et eshte organi qe drejton shoqerine dhe merr vendime per menyren e venies ne ekzekutim te politikave tregtare te shoqerise si dhe perfaqeson shoqenne ne marredheniet me te tretet.
2- Administratoret kane te drejte dhe detyrohen:
   a- te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise;
   b- te perfaqesojne shoqerine tregtare;
   c- te kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dh te librave kontabel te shoqerise;
   d- te pergatisin dhe te nenshkruajne bilancin vjctor, bilancin e konkoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te diet ia paraqesin keshillit mbikqyres per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve per t'u paraqitur me pas per miratim nga asambleja e pergjithshme.
   e- krijojne nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat, qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
   f- te kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise sipas parashikimeve te ketij ligji apo te ligjeve te tjera;
   g- te raportojne perpara keshillit mbikqyres per zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise;
   h- te kryejne detyra te tjera te percaktuara nc ligj dhe ne statut.

3- Administratori i pare i Shoqerise eshte Z **SADIK PISHA** - i datelindjes 14.05.1977 lindur ne Elbasan mbajtes i leternjoftimit, me numer personal H70514004Q.

4- Administratori i shoqerise eshte emeruar per nje periudhc tre vjecare me te drejten e rizgjedhjes.

## Neni 23
## Perfaqesimi

Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre regjistrohen prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 24**
**Prishja e Shoqerise**

Shoqeria prishet ne rastet e mcposhtme:

a- me vendim te asamblese se pergjithshme;
b- me hapjen e procedurave te falimentimit;
c- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i vcprimtarise, ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723. date 3.5.2007 "Pe Qendren Kombetare te Regjistrimit";
d- me vendim gjykate;
e- per arsye te tjera te parashikuara ne kete statut.

**Neni 25**
**Dispozitat e Fundit**

Ky Statut eshte hartuar nc 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet nga aksioneret thcmelues nenshkruhet pa verejtje.

**AKSIONERET**

**SADIK PISHA** | **BILBIL KASTRATI**

Datë : 04/10/2018